

FJALA E DEPUTETES ENSLEMVERA ZAKE

E ENJTE 7 KORRIK 2022

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave mori në shqyrtim raportin vjetor të veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2021 dhe vlerëson rolin e tij, si institucioni më i lartë shtetëror i auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë, i cili synon rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në përdorimin e fondeve publike. Për publikun që ndjek punimet e Kuvendit të Shqipërisë dhe raportin e KLSH-së, ku sot do të shqyrtohet edhe rezoluta përkatëse, ju informoj se Komisioni për Ekonominë dhe Financat, përveçse vlerëson punën e kryer nga institucionet e pavarura, jep gjithashtu edhe rekomandime për çështjet që kërkojnë përmirësim për shkak të rëndësisë dhe impaktit që kanë dhe ku duhet të adresohen me shumë.

Ajo që sot kërkoj të ve në dukje, sepse realisht mendoj se duhet vlerësuar dhe përgëzuar, lidhet me faktin se kjo maxhorancë është e vetmja forcë politike në vend, e cila asnjëherë nuk ka tentuar të emërojë në krye të Kontrollit të Lartë të Shtetit një përfaqësues të saj, siç ka ndodhur me drejtuesit e këtij institucioni ndër vite, të cilët kanë qenë emërtesa të Partisë Demokratike kur ka qenë në pushtet. Kjo ndryshe nga ne, që asnjëherë nuk kemi propozuar askënd nga Partia Socialiste, sepse qasja jonë është e ndryshme. Ne besojmë te ky institucion, i cili duhet të jetë tërësisht i pavarur. Ne e konsiderojmë KLSH-në si institucionin më të rëndësishëm auditues në vend për monitorimin e shpenzimit të parasë publike, sepse kjo na intereson më tepër.

Prandaj ne e vlerësojmë rëndësinë e funksionimit të këtij institucioni mbi bazën e garantimit të parimeve të pavarësisë, integritetit, objektivitetit, përgjegjshmërisë, interesit të publikut, profesionalizmit, bashkëpunimit dhe transparencës. Gjithashtu, ne duhet të nxisim kapacitetet për të forcuar auditimin dhe rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, sepse na intereson një kontroll tërësisht i pavarur dhe duhet të forcojmë bashkëpunimin duke ngritur nënkomisionin parlamentar brenda Komisionit të Ekonomisë dhe Financave për shqyrtimin e raporteve të KLSH-së. Gjithashtu, jemi ne fazën e hartimit dhe me pas të nënshkrimit të një memorandumi

mirëkuptimi midis dy institucioneve, si dhe hartimin e një plani pune për rritjen e kontrollit parlamentar për implementimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Nga ana tjetër, ky institucion duhet të jetë më proaktiv në dobi të auditimit dhe monitorimit të plotë të çdo qindarke të parasë publike që shpenzohet, duke rritur në këtë mënyrë besimin e qytetarëve te ky organ. Për vitin 2021 vlerësohet angazhimi i KLSH-së për kryerjen e auditimeve në pajtueshmëri me standardet dhe praktikat ndërkombëtare të auditimit, duke bërë të mundur përfundimin dhe evadimin e 158 auditimeve të ushtruara në 205 subjekte në nivel vendor dhe qendror, ku fusha e prokurimit publik është ndër fushat më me risk të lartë në buxhetin e shtetit. Pra, në vijim të kësaj që theksova më lart, konstatojmë se Kontrolli i Lartë i Shtetit auditon zbatimin e politikave dhe nuk bën politika. Vlerësohet adresimi i një numri total prej 4251 rekomandimeve për institucionet publike të audituara, nga të cilat 90 janë rekomandime për përmirësime ligjore, 3074 rekomandime organizative, 912 rekomandime disiplinore dhe 175 administrative.

Vlerësohet rritja e dobisë së rezultateve të auditimit, duke zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare, në fushën e menaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit, administrimin e pronës shtetërore dhe prokurimin publik. Vlerësohet angazhimi maksimal në të qenit aktiv dhe produktiv në luftën kundër korrupsionit, duke përkrahur, mbështetur dhe u angazhuar në çdo iniciativë ndërinstitucionale, brenda dhe jashtë vendit si dhe në ndjekjen e proceseve gjyqësore nga ana e KLSH-së. Po ashtu, vlerësohet rritja e besueshmërisë së publikut nëpërmjet trajtimit të 399 letrave dhe ankesave, nga të cilat pjesa kryesore i adresohet problematikave që lidhen me privatizimin dhe kthimin e pronës. Vlerësohet, gjithashtu, modernizimi i aktivitetit auditues dhe trajnimi i audituesve të KLSH-së.

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave kërkon që KLSH-ja për vitin 2022 të vazhdojë punën në këto drejtime: të fokusohet në auditime sistemi, duke riklasifikuar fushat audituese dhe duke marrë në konsideratë edhe kritere të tjera, si: prioritetet qeverisëse dhe ato subjekte që mbajnë peshën sektoriale buxhetore; të rrisë impaktin e auditimit nëpërmjet përmirësimit të qasjeve dhe cilësisë së raporteve si produkt i punës audituese, duke synuar nxitjen e ndryshimeve pozitive dhe përmirësimeve në drejtim të promovimit të qeverisjes së mirë në

vend; të nxisë mbikëqyrjen publike dhe të rrisë cilësinë, transparencën dhe parandalimin e korrupsionit në ofertat publike, koncesionet dhe partneritetet publik-privat nëpërmjet zhvillimit të auditimeve më cilësore, si dhe dhënien e rekomandimeve me vlerë të shtuar në mirëmenaxhimin e kontratave të PPP-ve, duke përmirësuar edhe kuadrin ligjor të realizimit të tenderëve publikë përkatës dhe të lidhjes dhe zbatimit të kontratave koncesionare; në funksion të rritjes së shkallës së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, duhet të forcojë bashkëpunimin me ekzekutivin dhe legjislativin nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të ndërtuara në bashkëpunim me këto institucione dhe të ketë një qasje bashkëpunuese me Ministrinë e Financave për kategorinë e rekomandimeve që paraqesin detyrime financiare shtesë në Buxhetin e Shtetit; të publikojë në vijimësi raportet e auditimit në faqen web, si dhe të angazhohet në pasurimin e platformës ndërinstucionale me hedhjen e të dhënave, sipas përcaktimeve në vendimin e Kuvendit për mekanizmit e monitorimit sistematik dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura, të përmirësojë treguesit e transparencës përmes komunikimit të rezultateve të KLSH-së për Kuvendin, publikun dhe palët e interesit, si dhe duke rritur nivelin e publikimeve të raporteve të auditimit në faqen zyrtare; të modernizojë kanalet e komunikimit për të forcuar mesazhet kyçe në qasje të çdo pale të interesit, duke aplikuar metoda dhe rrugë inovative, duke theksuar rëndësinë e komunikimit efektiv midis KLSH-së dhe publikut dhe rritjes së transparencës, si dhe të krijojë një hapësirë të dedikuar në faqen zyrtare për komunikim me publikun dhe institucionet; të angazhohet për optimizimin e kapaciteteve profesionale dhe burimeve njerëzore si dhe aftësive audituese; të intensifikojë bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare për përditësimin e vazhdueshëm të metodologjive të auditimit dhe aplikimin e praktikave më të mira në frymën e zbatimit të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të institucioni; të bashkëpunojë në mënyrë të vazhdueshme me faktorët kyç vendimmarrës në luftën kundër korrupsionit dhe vënien përpara përgjegjësisë të nëpunësve të lartë të shtetit, abuzues me interesin publik.

Së fundi, duke mbështetur dhe nxitur Kontrollin e Lartë të Shtetit për të punuar dhe kontribuar për një qeverisje të mirë, nëpërmjet parandalimit dhe luftës pa kompromis kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike, rritjes së besimit të publikut, nxitjes së përdorimit me ekonomikitet, eficiencë dhe efikasitet të fondeve publike, në përputhje me

kuadrin ligjor në fuqi dhe praktikat më të mira të BE-së e standardeve ndërkombëtare INTOSAI,
ju ftoj, kolegë deputetë, ta miratojmë këtë rezolutë! Faleminderit!